



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

## **KUVENDI I KOMUNËS**

### **Procesverbal i mbajtur më 17 dhjetor 2020, në mbledhjen e XXXIX (tridhjetë e nëntë) – solemne/inauguruese, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.**

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në ish ndërtesën e Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, përveç z.Afrim Shabani, z.Florent Hasani dhe Pajtim Hodolli të cilën munguan, (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekzistojnë kushtet për mbajtjen e mbledhjes, përkatësisht dhënien e betimit solemn nga z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i zgjedhur i Komunës së Podujevës në zgjedhjet e jashtëzakonshme të mbajtura më 29 dhjetor 2020.

Në mbledhje të pranishëm ishin përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të LMT KFOR – Podujevë, Deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përfaqësues të Shoqatave të dala nga Lufta, një numër i qytetarëve (rreth 70).

*Fillimisht para se të fillohet me seancën, lëshohen;*

***Intonimi i Himnit Kombëtar***

***Intonimi i Himnit të Republikës së Kosovës***

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke iu uruar mirëseardhje në seancën solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës si dhe duke kërkuar respektimin e masave dhe rekomandimeve të Qeverisë e Republikës së Kosovës dhe Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës-IKSHPK, për luftimin dhe parandalimin e Covid-19.

Pra edhe njëherë para se të fillojmë sipas agjendës kërkoj nga ju që t'i respektojmë masat, gjegjësisht rekomandimet dhe udhëzimet e IKSHPK, për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, të bëni kujdes, të respektoni mbajtjen e distancës, të vëni maska mbrojtëse dhe të bëni dezinfektimin e duarve.

Siç jeni në dijeni më 29 nëntor 2020, janë mbajtur zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës, ku pas certifikimit të rezultateve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve-KQZ, Kryetar i Komunës së Podujevës është zgjedhur z.Shpejtim Bulliqi.

Sipas rregullave ligjore në fuqi Kryetari i zgjedhur i Komunës duhet të jap betimin solemn para anëtarëve të Kuvendit të Komunës, andaj lidhur me këtë, ftoj Kryetarin e zgjedhur z.Shpejtim Bulliqi që të dal në foltore dhe të jap betimin.

## 1. Dhënia e Betimit solemn nga Kryetari i zgjedhur i Komunës

**z.Shpjetim Bulliqi, Kryetar i zgjedhur i Komunës së Podujevës**, duke falënderuar Kryesuesin e Kuvendit, me tekstin (deklaratën solemne të betimit), si në vijim, bënë betimin solemn si Kryetar i Komunës së Podujevës.

*Unë, SHPEJTIM NAZMI BULLIQI, betohem se do t'i kryejë detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat e mia si Kryetar i Komunës së Podujevës me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushtet për jetë të qetë për të gjithë.*

*(Nënshkruhet dokumenti i Betimit nga z.Shpjetim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës)*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urime ju dëshiroj punë të mbarë dhe suksese, njëkohësisht ju ftoj për fjalën e rastit zotëri Kryetar.

## 2. Fjala e rastit e Kryetarit të Komunës

**z.Shpjetim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës**, theksoi, i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, të nderuar anëtarë/e të Kuvendit të Komunës, të respektuara media dhe anëtarë të shoqërisë civile, të dashur aktivistë dhe përkrahës të Lëvizjes Vetëvendosje, të dashur qytetarë të Komunës së Podujevës, nuk mund të ndajë me ju emocionin dhe nderin e veçantë që kam, madje edhe në këtë moment tek sa po i'u drejtohem Ju të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe qytetarëve në përgjithësi. Krahas kësaj nuk mungon edhe ndjenja e lartë e përgjegjësisë që kemi, unë dhe bashkëpunëtorët e mi kur i llogarisim pritjet e qytetarëve të Komunës së Podujevës për modelin e shërbimit që ata presin nga ne, dhe për të cilin na kanë besuar.

Jam krejtësisht i vetëdijshëm se sot unë marrë një përgjegjësi të lartë që mu besua nga qytetarët e Podujevës, për t'i shërbyer një komuniteti dhe një rrethine të vendit tonë që assesi nuk është e parametrave të rëndomtë.

Edhe më parë e veçanërisht tani në këtë kohë kam reflektuar mbi historinë, trashëgiminë, traditat, dhe vlerat kolektive që ka pasur historikisht Llapi dhe Podujeva. Këto na e shtojnë ndjenjën e përgjegjësisë dhe dedikimin e plotë që besimin që na e dhanë qytetarët ta përkthejmë në realizim të pritjeve të tyre për të thelluar ndryshimet pozitive në vlerat esenciale të qeverisjes që i kërkon qytetari i Podujevës. Jam jashtëzakonisht i nderuar dhe po aq përgjegjës që në një proces thellësisht demokratik, me bindje të lirë e me vullnet të qartë, Llapjanët më kanë deleguar detyrën e drejtimit të Ekzekutivit të Komunës tonë, me bashkëpunëtorë e me profesionistë të dëshmuar të Llapit, do të drejtojmë një Komunë dhe një komunitet që ka nxjerrë emra të mëdhenj në të gjitha proceset e jetës shoqërore politike, kombëtare, kulturore, shkencore, artistike e sportive, një Komunë e një komuniteti që ashtu siç e ka dashur puna dhe detyra e atdheut tonë, i është përgjigjur siç është më së miri, pra një regjion me një traditë e identitet të fuqishëm Kombëtar e kolektiv të dëshmuar në çdo rrethanë.

Kur e ka dashur puna e sakrificës për lirinë, të drejtat dhe mëvetësinë e tij, Llapi i ka dhënë Kosovës emra si Adem Demaçi e Shaban Shala, kur e ka dashur puna që aspiratat tona kombëtare të merrnin formën e pa kompromis të rezistencës ndaj pushtimit, Llapi i ka dhënë Kosovës emra si Afrim Zhitia, Ali Ajeti, Zahir Pajaziti. Kur e kërkonte puna që aspiratat tona

Kombëtare dhe artikulimi i projektit politik për liri, pavarësi dhe vetëvendosje të pikë takoheshin me parimet universale politike, filozofike e morale të Botës së qytetëruar, Llapi i jepte Kosovës emra si Enver Maloku dhe Xhemajl Mustafa, kur më së shumti kishte nevojë që Kosova të dëshmonte vitalitetin, energjinë dhe përkushtimin kolektiv për vlera kulturore e artistike, Llapi i jepte Kosovës emra si Avdush Hasani, kur e njëjta ndihej në sportet kolektive, ne i kemi dhënë vendit sportistë si legjendat Fadil Vokrri e Favzi Rama.

Historia e organizimit politik e paralel të lëvizjes politike paqësore të viteve 90'ta dhe modeli i organizimit të luftës çlirimtare në fundvitet e 90'ta janë gjithashtu një tregim që e nderon Llapin dhe e rritë ndjenjën e krenarisë për mënyrën se si u përgjigjëm në ato sfida të peshës historike.

Të nderuar të pranishëm, zonja dhe zotërinj, i përmenda të gjitha epokat dhe personalitetet tona historike për të argumentuar bindjen time se sa herë marrim përgjegjësi para qytetarëve të kësaj komune, na takon të mbajmë parasysh sfidën dhe dedikimin total për të përmbushur atë për të cilën na kanë besuar qytetarët. E kaluara jonë është asgjë më pak se borxh, që të mos dështojmë në qëllimin tonë madhor për t'i dhënë Podujevës një të ardhme shumë më të mirë se sa nga situata që e kemi pasur deri më tani, duke siguruar zhvillim të qëndrueshëm e të gjithanshëm për çka ajo, i ka të gjitha resurset për të siguruar realizimin e atij qëllimi. Sot, edhe njëherë përmes kësaj fjale dua t'i nënvizoj disa nga parimet e mia udhëheqëse që i kemi prezantuar ditëve të kaluara me qytetarët tanë.

Unë sot zotohem para Llapjanëve që zyra e Kryetarit të Komunës do të udhëhiqet nga parimi i gjithë përfshirjes dhe trajtimit të barabartë sipas ligjit. Për mua dhe ekipin tim, nga sot qytetarët e Podujevës nuk ndahen më në “ne” dhe “ata”.

Shërbimi për qytetarët dhe ndaj qytetarëve, nuk do të jepet si nder, dhuratë apo shpagim politik, por si shërbim ndaj qytetarëve mbi bazën e ligjshmërisë dhe të kriterëve të meritokracisë. Thërras qytetarët, të rinjtë dhe kuadrot e shumta që ka Llapi, të cilët kanë vullnetin, dëshirën dhe idealin për të kontribuar me ide apo çfarëdo lloj ndihme për komunën e tyre, të na drejtohen, të na bashkohen dhe të na ndihmojnë.

Komuna e Podujevës do t'i mirëpres, dëgjojë e sigurojë bashkëpunim e bashkëveprim korrekt me ata, pa asnjë dallim a diskriminim. Zhvillimi i qëndrueshëm, zhvillimi ekonomik lokal, sigurimi i shërbimeve efikase për qytetarët dhe transparenca e plotë e mbi të gjitha kthimi i besimit të qytetarëve në institucionin e Komunës, nuk mund të sigurohen nëse ne në politikën tona nuk i përfshijmë energjitë e shumta profesionale që i kemi, segmentet e shoqërisë civile, mediat, komunitetin e profesionistëve, atë kulturor, artistik dhe intelektualët tanë.

E dimë se ky mandat zgjat vetëm 9 muaj, mirëpo në këta muaj do të punojmë që ta konfirmojmë ndryshimin edhe për katër vitet e tjera, në zgjedhjet që do të mbahen në vjeshtën e vitit 2021.

Me këtë vizion, unë kërkoj ndihmën nga secili prej jush. Çdo njëri që beson në këto vlera në Komunën tonë, është partner i udhëheqjes së re të Komunës.

Në këtë rrugë time që fillon nga sot, unë zotohem se do të udhëhiqem nga ligji, nga parimet politike të Lëvizjes Vetëvendosje, dhe nga vullneti juaj për të avancuar qeverisjen tonë e cila ka për fokus qytetarin e Podujevës, pa dallim. Çka do që nuk mund të bëhet për shkak të kohës apo pamundësive financiare, do ta diskutojmë bashkë me transparencë të plotë, e çka do që mund të bëhet, do të bëhet duke u konsultuar me qytetarët e duke mbajtur raport korrekt me mediat.

Dua t'i falënderoj qytetarët, aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje, por edhe bashkëpunëtorët dhe kolegët nga partitë tjera apo edhe ata pa parti, që na u bashkuan, na votuan e me të cilët ne bëmë një fushatë me përmbajtje e mesazhe pozitive që e fuqizuan raportin tonë të ndërsjellë me qytetarët si dhe i dhanë cilësi të re demokracisë tonë në rrugën e saj të konsolidimit.

Dua t'i falënderoj edhe ata qytetarë që nuk më votuan mua por besuan më shumë tek alternativat tjera, për sjellje korrekte, dinjitoze dhe që u sollën si qytetarë të denjë.

Për të dy këto segmente të shoqërisë dua të dërgoj porosinë time se do të jem kryetar i të gjithëve dhe do t'u shërbejmë duke mos e vënë në dukje për asnjë moment dallimet legjitime politike sepse kështu na thotë ligji, kështu na thonë shembujt e demokracisë liberale nëpër botën e qytetëruar dhe më e rëndësishmja mbi bazën e këtyre shembujve ne jemi frymëzuar kur kemi ndërtuar projektin tonë të politikës së ndryshimeve pozitive në shoqërinë dhe institucionet tona.

Ju faleminderit!

*Kryesuesi i Kuvendit, duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në ora 10:30**

**Procesverbalin e mbajti  
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0074368/20  
Podujevë,  
07 dhjetor 2020**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Fatmir Gashi**